



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 69

Datë: 21. 10. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

Raport nga QNR-ja.

- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Buxhet dhe financa:

- Shqyrtimi dhe miratimi i shumës së pagesave për stafin e angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për zgjedhjet e lokale 2021.

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional të zgjedhjeve lokale 2021, raundi i dytë për kryetar të komunave.
- Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për përfaqësimin në KVV për subjektet politike që garojnë për zgjedhjet lokale 2021, raundi i dytë për kryetar të komunave.

4. Të ndryshme.

Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi : E hapim mbledhjen e 69-të të vitit 2021 të KQZ-së, para vetes e keni rendin e ditës, ka dikush diçka...?

Burim Ahmetaj: KQZ i duhet vendimi për përcaktimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale dhe, është pikënisje për të filluar të gjitha aktivitetet tjera për të përgatitur për raundin e dytë...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për këtë rend të ditës ?

Me vota unanime miratohet rendi i ditës.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së

Raport nga QNR-ja:

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtarë të KQZ-së: Qendra e Numërimit dhe Rezultateve është e hapur nga data 17 tetor kur kanë filluar përgatitjet për pranimin e materialeve të ndjeshme nga të gjitha komunat nga tërë territori i Republikës së Kosovës , procesi ka vazhduar në ditën e hënë me datën 18 tetor në orët e hershme të mëngjesit kur kanë ardhur edhe arritjet e para të gjithave materialeve zgjedhore dhe është përfunduar me datën 19 tetor në orët e hershme të mëngjesit, kur janë pranuar dhe konfirmuar se janë pranuar të gjitha materialet e ndjeshme nga të gjitha komunat.

Gjatë procesit të pranimit të materialit të ndjeshëm, një numër i vendotimeve nuk kanë mundur të procedohen si të rregullta për shkak të parregullsive. Kryesisht, problematikat kanë qenë kanë pasur të

bëjnë më ndërrimin e numrave të shiritave të sigurisë, formularëve zgjedhorë të panënshkruar apo mospërputhje të numrit të nënshkrimeve në listën e votuesve me kusht, dhe numrit të zarfeve të fletëvotimeve me kusht...

Pra, këto kanë qenë problematikat më kryesore në bazë të cilave QNR nuk ka mundur ti procedojë një numër të konsiderueshëm të materialeve zgjedhore dhe për këtë qëllim janë dërguar në karantinë për tu hetuar pastaj nga QNR . Më lejoni të ju njoftoj se procesi është duke vazhduar në QNR me procesin e futjes së të dhënave nga formularët e rezultateve dhe në këtë kohë kur po raportojmë deri në raportin e orës 12 të datës së sotme. Formularët e rezultateve për kryetarë komune janë proceduar në masën 82.57 % , formularë të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve për kuvendin komunal janë proceduar deri më tani 80.09 % , formularë të rezultateve të kandidatëve 82.12 % dhe listat përfundimtare të votuesve në masën 62 %.

Nga raporti i procedimit të të dhënave, shihet se nuk kemi numër shumë të madh të vendvotimeve të cilat janë në auditim mirëpo, QNR është duke e përgatitur edhe raportin e auditimit të cilin do ta paraqes para KQZ-së me të gjitha të gjeturat sa i përket procedimit të rezultateve që kanë të bëjnë për kryetar komune, për kuvendin komunal dhe rezultateve të kandidatëve. Gjithmonë, prioritet i është dhënë procedimit të rezultateve për kryetar komune dhe, jemi duke bërë përpjekje që të gjitha aktivitetet të fokusohen në këtë drejtim në mënyrë që ti kemi sa më shpejtë rezultatet.

Mirëpo, për ti hapur rrugë këtij procesi dhe për ti hapur rrugë procesit të votave me kusht nevojitet së pari të pastrohet karantina pra të hiqen të gjitha materialet të cilat janë dërguar në karantinë për shkak të parregullsive teknike administrative në ditën e zgjedhjeve dhe, QNR nuk ka mundur ti procedojë si të rregullta. Në lidhje me këtë, në bazë të të gjeturave kemi rekomandime që praktikisht i kemi 6 rekomandime të cilat i kemi sjellë para juve me qëllim që të marrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendim për të proceduar me të gjitha këto materiale dhe pastaj QNR të procedojë më tutje.

Rekomandimi i parë, ka të bëjë me një numër të vendvotimeve pra nuk kanë mundur të pranohen si të rregullta, dhe rezulton se nga të gjeturat nuk ka mospërputhje, pra nga të gjeturat për një numër të konsiderueshëm të materialeve që ka të bëjë me zarfet me fletëvotimet me kusht dhe me fletat llogaritëse të kandidatëve, pas hetimeve, rezulton se nuk ka mospërputhje në mes të nënshkrimeve në listën e votuesve me kusht dhe zarfeve të fletëvotimeve me kusht. Po ashtu, e gjetur tjetër është edhe verifikimi i shiritave të sigurisë dhe palosja në mënyrë jo të rregullt e zarfeve të fletëvotimeve me kusht! Për të gjitha këto kategori që janë hetuar nga QNR dhe ka ardhur nga hetimi që është bërë, QNR ka përgatitur

praktikisht rekomandimin për KQZ-së në: të gjitha zarfet e fletëvotimeve me kusht nga vendvotimet si në listë që e keni para vetes, është rekomandimi 1 dhe në të cilën nuk ka mospërputhje të nënshkrimeve në listën e votuesve me kusht dhe numrit të zarfeve të fletëvotimeve me kusht. Kategoria tjetër, fleta llogaritëse që ka qenë brenda kutisë së votimit, aty janë gjetur dhe janë vendosur sipas procedurave palosja jo e rregullt e zarfeve të fletëvotimeve me kusht që nënkupton se, në shumë raste zarfet e fletëvotimeve me kusht praktikisht zarfet e sigurisë, kanë qenë të vendosura në zarfe të fshehtësisë dhe se, është dashur të bëhet ripalosje pa e cenuar fshehtësinë e votës, si dhe verifikimi i shiritave të sigurisë në të cilat pas procesit të verifikimit, sipas procedurave, rekomandohet që të gjitha këto vendvotime apo këto materiale të këtyre vendvotimeve të procedohen si të rregullta.

Në tabelën 1, janë të listuara të gjitha këto raste dhe janë të listuara në rekomandimin 1, dhe rekomandohet që të gjitha këto materiale të procedohen si të rregullta. Por, janë edhe disa rekomandime të tjera nëse dëshironi të shkojmë rekomandim për rekomandim ,apo ti prezantojmë të gjitha... !

Kreshnik Radoniqj: A keni diçka lidhur me këtë pjesë të krye shefit, apo të shkojmë me të gjitha rekomandimet. A po shkojmë një nga një...?

A keni diçka lidhur me këtë pjesë të rekomandimit të parë ?

Florian Dushi: Unë, e di natyrën e punës dhe kohën e shkurtë dhe gjithë proceset që zhvillohen brenda QNR-së, megjithatë kërkoj që këto lista t’i kemi pak para takimeve të KQZ-së ose, për një kohë brenda të cilës, ne do të kishim mundësi me e analizuar secilin rast veç e veç, jo secilin rekomandim po, secilin rast veç e veç...

Alim Rama: Ne, mundemi me shkuar edhe një nga një, me shkuar rast për rast, nuk kam asgjë kundër por, mendoj që merr shumë kohë ...

Burim Ahmetaj: Jemi munduar që t’i mbledhim sipas problematikave që i kemi gjetur gjatë hetimit në procesin e gjithë materialeve që janë dërguar në karantinë, dhe i kemi grumbulluar në “rekomandimin 1”...

Florian Dushi: Kur na i keni dërguar këto materiale ?

Burim Ahmetaj: Është dashur të punojmë dy ditë për t’i klasifikuar, dhe i kemi dërguar sot.

Florian Dushi: Unë po flas për secilin vendvotim. Për mua ka peshë secili vendvotim madje, secila votë prandaj unë po kërkoj që rekomandimet për secilin rast, veç e veç t’i kemi për një periudhë kohore më të

gjatë brenda të cilës, ne do të kishim mundësi me i analizuar sepse, unë e di kur kanë ardhur këto materiale...

Arianit Elshani: Po ashtu, edhe unë kërkoj që këto materiale ti kemi një ditë përpara edhe pse me rregulloren e brendshme, detyroheni, pra që disa ditë përpara ti kemi edhe rendin e ditës, edhe të gjitha materialet mirëpo, mos të harrojmë që ne pra kalojmë disa muaj duke u përgatitur për zgjedhjet kemi një plan operacional që përgatisim që sigurohemi që dita e zgjedhjeve të shkojë sa më mirë prandaj, nuk është mirë që pas zgjedhjeve ti përshpejtojmë hapat në raport me vendimet të cilat duhet ti marrim.

Unë, tha z. Elshani, mendoj se duhet kohë të trajtohen secila veç e veç mirëpo, duke ditë këtu edhe angazhimin e stafit në QNR edhe krye shefit në këtë rast, edhe përvojën në raport me gjithë këtë proces, unë i pash të listuara këtu të gjitha mangësitë të cilat kanë qenë te disa kuti të votimit të cilat, sipas rekomandimeve disa do të procedohen si të rregullta, disa të tjera do të anulohen, disa të tjera do të rinumërohen. Pra, do të anulohen ato zarfet e sigurisë të cilat, nuk përputhen me listën votuese dhe nuk plotësojnë kriteret por ajo çka kërkoj unë pra krahas kësaj liste që e kemi këtu është që të merren masa krahas kryesuesve të këtyre vendvotimeve, dhe të sigurohemi që në procesin në raundin e dytë në këto komuna ku do të ketë balotazh që këta kryesues që kanë bërë kësi lloj lëshime brenda që janë të listuar, të mos kryesojnë ato vendvotime sepse, vërtetë është një numër jo shumë i madh por që mund të ndikojë në procesin dhe këtë rast vonesat që na i shkakton neve edhe në certifikim të rezultateve...

Kreshnik Radoniqi: Dikush tjetër diçka lidhur me rekomandimin e parë ?

Urdhëro Alim ?

Alim Rama: Listat janë shumë në detale, ndoshta keni mundur me pa edhe në QNR procesin e verifikimit dhe, unë vetë personalisht dje i kam parë edhe problematikat...Nuk shoh problem, se problematika ka qenë shumë e thjeshtë...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, unë e hedh në votim rekomandimin e parë. Kush është për miratimin e rekomandimit të sekretariatit?

Me vota unanime aprovohet rekomandimi i sekretariatit që të gjitha këto kuti votimi të procedohen si të rregullta. Vazhdojmë me rekomandimin e dytë.

Burim Ahmetaj: Te kategoria e dytë apo rekomandimi i dytë i kemi në bazë të hetimeve që janë bërë, i kemi listuar të gjitha problemet dhe i kemi grumbulluar me një vend dhe rekomandimi është që këto zarfe të anulohen. Pra, është fjala gjithmonë për zarfet e fletëvotimeve me kusht dhe rezulton se te një numër

i fletëvotimeve zarfet e fletëvotimeve me kusht kanë qenë të paplotësuara apo palosja, nuk ka qenë sipas procedurave me të cilat i kemi trajnuar komisionarët dhe lista e votuesve me kusht që mungojnë. Pra, edhe pas hetimit rezulton se këto materiale nuk mund të procedohen si të rregullta për shkak të mosrespektimit të procedurave.

Në rekomandimin e dytë në listë vetëm te një numër 46, na duhet të konfirmojmë edhe njëherë se ndoshta ka mund të qenë një gabim teknik mirëpo të gjithë rastet tjera është që të anulohen pra arsyeja është që palosja nuk ka qenë sipas procedurave, lista e votuesve me kusht mungon në disa raste dhe pas hetimit rezulton se të gjitha këto materiale nuk mund të procedohen si të rregullta dhe rekomandohen që të anulohen pra është fjala për zarfet e fletëvotimeve me kusht, i keni të listuara sipas komunave po ashtu edhe vendvotimeve.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka lidhur me rekomandimin e dytë ?

Sami Kurteshi: Faleminderit për raportimin, nuk kam ndonjë vërejtje shumë serioze, a bën me shpjegua çka do të thotë me u anuluar ?

Burim Ahmetaj: Të anulohen nënkupton që të mos procedohen më tutje; Nuk mund të procedohen nga KQZ për shkak se mungon lista e votuesve me kusht dhe në këtë rast, ne nuk kemi me çka me krahasua sepse nuk kemi as të dhëna të votuesve që kanë votuar në atë vendvotim dhe nuk kemi as nënshkrime: i kemi vetëm zarfet dhe në këtë rast, nuk mund të procedohen më tutje si të rregullta dhe nuk mund të përfshihen në asnjë mënyrë të gjitha këto në rezultatet përfundimtare...

Sami Kurteshi: E pasoja cila është e anulimit ?

Burim Ahmetaj: Refuzohet zarfi.

Sami Kurteshi: Në rregull çka pastaj ?

Burim Ahmetaj: Do të na duhet me ndjekë rastin dhe me analizuar se pse ka ndodhur, duhet me e hetuar më tutje te komisionarët.

Sami Kurteshi: A shkojnë këto vendvotime në rinumërim, a jo ? Mirë, unë mendoj se nëse ju e keni të qartë, vetëm ma sqaroni unë nuk e kam asnjë problem veç unë dua ta di se çfarë ndodhë me vendvotimin 0320e 03d në Glllogovc ?

Burim Ahmetaj: Materialet e vendvotimit të rregullt nuk kanë problematika , problemin e kemi me zarfet e fletëvotimeve me kusht , me votat me kusht të cilat nëse më lejoni ta lexoj një problematikë pra janë 14

nënshkrime në listën e votuesve me kusht dhe 15 zarfe të fletëvotimeve me kusht të cilat zarfet e fletëvotimeve me kusht kanë qenë të paplotësuara fare, kështu që i kemi nënshkrimet në listën e votuesve kusht zarfet e fletëvotimeve me kusht kanë qenë të paplotësuara, kështu që këto nuk mund ti procedojmë si të rregullta se nuk e dimë të kujt kanë qenë.

Thjeshtë, nuk është respektuar procedura, mungesa e listës të votuesve me kusht po ashtu fletëvotime pa zarfe të sigurisë d.m.th., i kanë sjellë vetëm zarfet e fshehtësisë d.m.th., nuk kemi asnjë të dhënë për ata votues se kush ka votuar, dhe s'kemi me çka me krahasuar, pra gjithmonë bëhet fjalë në këtë rast për rekomandimit të dytë vetëm me zarfet e fletëvotimeve me kusht, ndërsa vendvotimet e rregullta procedohen si të rregullta dhe asgjë nuk ndodhë me vendvotimet e rregullta. Pastaj, vendvotimet e rregullta i nënshtrohen procedurës së procedimit në data bazë, e pjesa matematikore varet se çka përmbajnë të dhënat brenda formularëve...

Më tej, diskutuan: Alim Rama, Sami Kurteshi, Florian Dushi dhe Arianti Elshani. Në fund, me vota unanime u miratua edhe rekomandimi i dytë që votat me kusht të anulohen.

Kreshnik Radoniqi: Vazhdojmë me rekomandimin e tretë...

Burim Ahmetaj: Prapë, jemi duke folur për zarfet e fletëvotimeve me kusht mirëpo, tash e kemi një natyrë tjetër sepse të gjithë zarfet me fletëvotime me kusht një apo një numër shumë i vogël i tyre duhet të anulohen për shkak se mungon nënshkrimi ose në listën e votuesve me kusht ose anasjelltas. Mirëpo, kur i kemi bërë krahasimet e nënshkrimeve me listën e votuesve me kusht dhe numrin e zareve për secilin votues që ka hedhur votën dhe është regjistruar, në zarf rezulton se në shumicën e rasteve mungon nga një nënshkrim, dy apo më shumë nënshkrime në listën e nënshkrimeve me kusht çka nuk mund ta validojmë si të tillë dhe nuk mund ta procedojmë më tutje sepse mungojnë të dhënat elementare në listën që për neve është njëjtë si lista përfundimtare e votuesve, e po ashtu edhe lista e votuesve me kusht të cilën sipas procedurës komisionarët janë të obliguar në kuadër të këshillave të vendvotimeve ti shënojnë të gjitha të dhënat të votuesit në listën e votuesve me kusht.

Pastaj, sipas procedurës duhet të procedohen me të dhënat në zarfin e fletëvotimit me kusht dhe të dyja, duhet të nënshkruhen nga votuesi në mënyrë që të legjitimohet mirëpo, për neve është me rëndësi po ashtu edhe nënshkrimi i votuesit me kusht në listën e votuesve me kusht. Në të gjitha rastet në këtë kategori, rezulton se kemi të bëjmë me një apo më shumë zarfe të cilat duhet të anulohen për shkak se mungon nënshkrimi në listën e votuesve me kusht dhe rekomandimi është që sipas listës në kategorinë e rekomandimit të tretë që ka të bëjë gjithmonë me zarfet e fletëvotimeve me kusht të anulohen, ndërsa

zarfet e rregullta të cilat pas hetimit rezulton se përputhen gjithçka edhe në listën e votuesve me kusht edhe me numrin e zarfeve ato tjerat të procedohen të rregullta...

Kreshnik Radoniqi: Dikush tjetër lidhur me rekomandimin e tretë ?

Sami Kurteshi: Unë kam bërë përpjekje me i pa me kujdes çështjen...Për mua, është vërtetë një pyetje shumë interesante: si është e mundur që të gjitha këto trajnime që i kanë këto këshillat e vendvotimeve, me lejua me kaluar pa nënshkrim ose lista, ose zarfa kur ata e kanë njëfarë protokollit të veprimeve: së pari nënshkruhet në listë, pas listës nënshkruhet, merren të dhënat etj. Unë kam votuar vet me kusht: futet në zarf edhe një listë që e kanë aty... Por mua po më intereson sinqerisht si po ngjanë , janë disa gjëra tjera që mungon fleta e votimit ose fliku ose diçka por thjeshtë futet një zarf që nuk dëshmon që dikush ka votuar kudo që mungon nënshkrimi diçka nuk është në rregull , a keni ju hiç përshtypje a ju raportojnë ata çka është duke ngjarë ?

Kreshnik Radoniqi : Dikush tjetër lidhur me rekomandimin e tretë ? Urdhëro z. Dushi ?

Florian Dushi: Tash këtu praktikisht brenda të njëjtit rekomandim i kemi dy forma të shkeljeve të cilat janë gjetur , e para është kur ne kemi më shumë zarfe dhe më pak nënshkrime në listën e votuesve me kusht shembuj këtu ka të mjaftueshëm por ta marrim 10 nënshkrime i kemi ndërkohë 12 zarfe me kusht, si me i anuluar cilat me i anuluar ato dyja ? Cilat zarfe i anuloni ? A i krahasoni të dhënat në zarf me të dhënat në listë? E tash, e kundërta kur kemi më shumë nënshkrime e më pak zarfe, prapë e bëjmë krahasimin dhe, ne e dimë se cilat nënshkrime nuk i kanë zarfet brenda. Por çka do të thotë për KQZ-në me anuluar nënshkrimin ?

Burim Ahmetaj: Ia vlen me e shpjegua gjithë këtë situatë në raport me zarfet me fletëvotime me kusht që është një problematikë që me vite të tëra po thuajse na përcjell në secilin proces zgjedhor natyra po thuajse është e njëjtë mirëpo te pyetja se me çka e krahasojmë ne gjithmonë e krahasojmë secilin zarf me secilin votues që ka votuar me kusht në listën e votuesve me kusht dhe kjo është ajo që krahasojmë ,në raste kur kemi nënshkrime më pak dhe i krahasojmë se cili është ai zarf që i mungon nënshkrimi në listën e votuesve me kusht ai zarf duhet të anulohet d.m.th., të mos përfshihet në rezultate ...

Mirëpo, e kemi dhe pjesën tjetër pak paradoksale kur e kemi një nënshkrim më shumë se sa zarfe që praktikisht neve do të na duhet për me u përputh sipas procedurave gjithçka do të na duhet për me eliminu apo me anuluar atë nënshkrim që praktikisht nuk na kanë sjellë zarfin tash ndoshta sqarimet mund të na japin komisionarët që kanë punuar aty mirëpo te ne rezulton se kemi një nënshkrim të gjitha

të dhënat e votuesit mirëpo mungon zarfi mirëpo të gjitha i krahasojmë listën e votuesve me kusht emër për emër në zarfet e fletëvotimeve.

Alim Rama: D.m.th., këtu kemi anulimin e nënshkrimeve për shkak të barazimit d.m.th. që të kemi me vazhduar më tutje në nëse kemi 30 nënshkrime duhet me i pas 30 zarfa...

Burim Ahmetaj: Sepse, kjo pastaj na tregon numrin e zarfeve të fletëvotimeve me kusht në total nëse e kemi një nënshkrim më shumë atëherë nuk na qet gjendjen reale të të gjitha zarfeve të fletëvotimeve ,, për këtë çështje procedurale do të na duhet edhe atë nënshkrim me e anuluar në mënyrë që të barazohet dhe ta dimë numrin e saktë sa zarfe të fletëvotimeve me kushtmirëpo neve na duhet me e barazuar me gjithçka.

Sami Kurteshi: Pikërisht ne po bisedojmë për raste të veçanta individuale që ka të bëjë me një votë dhe kjo është pak e çuditshme megjithatë është një protokoll kur po hyn në vendvotim edhe kutia me kusht edhe kutia për votim një njeri po rrinë aty , po shikon ,ata po i marrin nënshkrimet nuk mundesh me kaluar nuk është e mundur mua po ma merr mendja që nuk është e mundur me hy në një vendvotim me i kalua krejt këta filtera edhe me të ardh një zarf më shumë se nënshkrime nëse një njeri rrinë aty! Ky, është një problem që nuk të lejon me qenë i qetë , çfarë është duke ngjarë ? a janë duke fjetur ata njerëz ?.... ose nuk rrinë në vendvotim. Pikërisht kjo është pyetja ime: nëse janë duke fjetur, ne jemi të gjithë njerëz dhe në rrethana të caktuar na zë gjumi por ajo mund të falet disi edhe nëse është i pakujdesshëm ka dalë me fol në telefon. Unë, këtu e kam problemin që e përmendi kolegu Selmani, se a mos po e qesin vetë ?

Prandaj, shumë komisionarë, shumë njerëz që i kemi dërguar si komisionarë prej partive politike janë frikësuar, janë tërheq prej garës sepse nuk janë frikësuar nga ndonjë sanksion por, po frikësohen nga përgjegjësia, nuk duan të marrin përgjegjësi që ka pasoja edhe kjo e tregon nivelin e edukimit dhe trajnimit të ne! Njerëzit janë mësuar me pa përgjegjësi...

Burim Ahmetaj: Më lejoni të ju informoj që në bazë të procedurave ..pos këtij kontrollit që e bëjmë administrativ protokollit të zarfeve të fletëvotimeve me kusht në këtë fazë ne e kemi edhe një kontroll tjetër që e bëjmë gjithë këta votues të cilët janë të suksesshëm që janë potencial me u numërua vota e tyre duhet të kontrollohen me votuesit e rregullt dhe aty do ta gjejmë nëse dikush e ka shfrytëzuar të drejtën më shumë se sa ia jep ligji të votojë vetëm njëherë, dhe të gjitha ato raste duhet ti gjejmë përmes sistemin dhe pastaj do ti raportojmë edhe te ju...

Ibrahim Selmanaj: Në bazë të informatave që, i posedojmë janë të specifikuar në raste të veçanta duke pas parasysh se janë të adresuara të saktë të dhënat dhe informatat. Mendoj se shumë seriozisht, duhet

të merremi ne pas këtyre zgjedhjeve pikërisht me këto elemente... Të njëjtat pika, të njëjtat adresa se është më e lehtë për neve edhe me ditë me i parandalua se zgjedhje ka me pas sidoqoftë, ne duhet me kalua dhe me proceduar përpara unë po më vjen tepër mirë që është kaq e specifikuar...

Rifat Krasniq: Pse po dalin se unë e di si dalin...! Ata dalin, janë marrë vesh edhe te nënshkrimet që rrinë te ai komisionari dhe, ai që i vulos letrat p.sh., votat me dhënë disa janë letra, po i jep 4-5..... edhe nuk mundet me u marrë vesh me nënshkruar...Në komunën e Mamushës, janë njerëz që jetojnë, janë afër 1500 në Turqi, edhe ata e dinë p.sh. që vëllau i Rifatit nuk ka ardhur këtu, jeton në Turqi edhe ai e qet nënshkrimin.... Do komisionar, janë aty! Ata, janë elemente që bëjnë dallaveret...

Kreshnik Radoniq: Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka tjetër unë e hedhë në votim rekomandimin e tretë. Kush është për aprovimin e rekomandimit të tretë ?

Me vota unanime, aprovohet rekomandimi i tretë i Sekretariatit. Vazhdojmë me rekomandimin e katërt...!

Burim Ahmetaj: Më lejoni ta prezantoj një problem tjetër që është gjetur gjatë procesit të pranimit të materialit zgjedhor që ka të bëjë me disa vendvotime që kanë mospërputhje , që kanë pasur mospërputhje me numrat e shiritave dhe kutisë së votimit që nuk janë përputhur me numrat e shiritave të shënuar në formularë të rezultateve , në raste tjera formularët e rezultateve kanë qenë të paplotësuara apo kanë qenë plotësisht të plotësuara dhe në disa raste mungojnë nënshkrimet e anëtarëve të këshillave të vendvotimit.

Në listë, i keni të listuara të gjitha problematikat, i keni te kategoria apo lloji i zgjedhjeve në tabelë e sqaron se për cilin lloj të zgjedhjeve bëhet fjalë dhe për cilën formë bëhet fjalë dhe nga tabela rezulton se bëhet fjalë për 8 vendvotime për kryetar komune të cilat rekomandohen që të rinumërohen dhe 15 vendvotime për kuvendin komunal që duhet të rinumërohen në bazë të rekomandimit që e keni para jush pra rekomandohet KQZ që të gjitha vendvotimet si në listë të cilat rezulton se shiritat e vendosur në kutitë e votimit kanë mospërputhje me shiritat e regjistruar në FPR.

Në raste tjera kur në formularët e rezultateve kanë qenë të paplotësuara apo pjesërisht janë plotësuar nga anëtarët e këshillave të vendvotimit, dhe rastet tjera kur mungojnë nënshkrimet e anëtarëve të këshillave të vendvotimit, pra, të gjitha këto vendvotime të rinumërohen. Rekomandimi është që të bëhet rinumërimi i plotë pra për kryetar komune janë 8 dhe për kuvendin komunal janë 15 vendvotime që ,nënkupton do të numërohen votat për subjekt dhe kandidatë....

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka, atëherë e hedh në votim. Kush është për aprovimin e këtij rekomandimi ?

Me vota unanime miratohet rekomandimi i katërt. Vazhdojmë me rekomandimin e pestë...

Burim Ahmetaj: Rekomandimi i pestë, ka të bëjë me një natyrë e cila është po thuajse pak e pazakonshme në proceset zgjedhore të cilat i kemi organizuar deri më tani dhe në 4 raste është gjetur në kutinë për kuvendin komunal janë gjetur nga një fletëvotim për kryetar të komunës! Nga të gjeturat rezultoi pra QNR i ka bërë të gjitha vërtetimet dhe ka gjetur se ai fletëvotim në bazë të kriterëve më së pari a është i vlefshëm, ka kontrolluar se ai fletëvotim a i takon atij vendvotimi dhe për cilin lloj të zgjedhjeve bëhet fjalë. Në disa raste anëtarët e këshillave të vendvotimit i kanë shënuar edhe në librin e votimit arsyen se pse ky fletëvotim është gjendur në kutinë për kuvendin komunal.

Kemi rastin në Kaçanik, ku një fletëvotim për kryetar komune gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit në librin e votimit kanë shënuar arsyen se gjatë është kryer procesi i numërimit të votave për kryetar komune kur është hapur kutia për kuvend komunal është gjetur një zarf i vlefshëm i nënshkruar edhe i plotësuar për kryetar të komunës po ashtu nga komunikimet edhe me zyrtarët komunalë kemi konfirmime se ato fletëvotime janë gjetur në kutinë për kuvendin komunal.

Pra, si rekomandim meqenëse pasi i kemi hetuar dhe gjetur se të gjitha ato fletëvotime i takojnë llojit të zgjedhjeve për kryetar komune dhe i takojnë atij vendvotimi dhe rekomandohet që të përfshihet në rezultate përfundimtare të atij vendvotimit. Bëhet fjalë për nga një fletëvotim për 4 vendvotime, dhe është një natyrë e pazakontë e cila nuk është as në procedurë apo diku tjetër si të tillë e kemi prurë rekomandimin pastaj KQZ të vendos se a do ta procesojnë si të rregullt atë fletëvotim që është hedhur gabimisht për kuvendin komunal apo të mos përfshihet në rezultate.

Sami Kurteshi: Tash, ne i kemi veç në rastin e zgjedhjeve komunale për kuvend komunal dhe kryetar komune. Kjo nuk mund të vërehet ndoshta bash lehtë sepse, e kemi vetëm një nënshkrim d.m.th., një votues nënshkruhet njëherë identifikohet por i merr dy fletëvotime edhe nuk mund të vërtetohet se ka diçka, se po të ishin dy nënshkrime, një për kryetar komune dhe një për kuvend komunal mandej mund të shihet a ka ndonjë manipulim, apo s'ka...

Mendoj që është e vetmja gjë me shikuar se, a janë, a përputhen nënshkrimet në numër të votave! Nëse përputhen, gabimi është njerëzor sepse në një vendvotim në shkollën "Abaz Ajeti" në Gjilan në qendrën e votimit, shkoj unë dhe shoh se janë vetëm 3 persona prej komisionarëve në vendvotim! Nuk e di cili vendvotim! Pyes, identifikohem kush jam dhe pyes ku janë këta dhe ata thonë se dolën, patën pak

punë...Tash, si ishte rasti unë po ju tregoj që ju ta keni parasysht: personit që e mbante llambën, kryesuesi i ka thënë se “deri sa unë të kthehem ti je kryesues”. Ai që e mbante llambën me qenë edhe kryesues edhe me qenë personi që kontrollon hedhjen e votës...?

Unë po ju tregoj konkretisht se çka kam parë dhe nuk është kjo se po e marr me mend! Unë ju tregova cila shkollë është, dhe a është kjo e lejshme! Unë mendoj se mundet me qenë qoftë veç edhe 10 minuta por në ato 10 minuta, një njeri nuk mundet me i krye tri punë përnjëherë! Ky është problem, duhet me pas kujdes...

Ibrahim Selmanaj: Unë po besoj se është një gabim krejt i thjeshtë, është një gabim që zarfi në vend se me kaluar në një kuti, ka kaluar në një kuti tjetër dhe si i tillë, duhet me u pranuar dhe duhet me u shpall si vota të vlefshme...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, kush është për miratimin e rekomandimit të pestë ?

Me vota unanime është aprovuar rekomandimi numër i pestë. Vazhdojmë me rekomandimin e radhës...

Burim Ahmetaj: Pra, në listën e të gjitha kontrolleve që i kemi bërë të materialeve të cilët nuk kemi mundur t’i pranojmë si të rregullta gjatë procesit të trajnimit, dhe është dashur kohë që të analizohen dhe hetohen se është edhe një vendvotim që përfshihet në rekomandimin e 6 –të dhe, ka të bëjë me disa materiale të cilat janë konfiskuar në policinë e Kosovës nga policia hetuese. Mirëpo, materialet tjera siç janë formularët e rezultateve janë sjellë në mënyrë të rregullt dhe ato për qëllimin e analizimit nuk kemi mundur t’i procedojmë si të rregullta.

Dhe rekomandimi, është që materialet sic janë formularët zgjedhorë, të procedohen të rregullta edhe përkundër faktit se disa materiale apo fletëvotime janë konfiskuar nga policia në komunën e Fushë Kosovës.

Kreshnik Radoniqi: Kutia e votimit është në polici ?

Burim Ahmetaj: Jo, kutia e votimit është sjellë dhe të gjitha format zgjedhor janë sjellë mirëpo, një pjesë e materialeve brenda kutisë së votimit janë të konfiskuara nga policia hetuese ditën e zgjedhjeve...

Alim Rama: Kryesues te ky rast i veçantë, materialet veç janë në polici, disa fletëvotime janë konfiskuar...

Burim Ahmetaj: Në ditën e votimit, është raportuar po ashtu edhe në dhomën operative se kemi problem në mes komisionarëve në vendvotimin 0906..... /01... dhe si rezultat i kësaj, policia hetuese nuk ka lejuar që të vazhdojë puna për pa u bërë zëvendësimi i anëtarëve të këshillave të vendvotimit. Sipas

informacioneve, diku janë 3 anëtarë të KVV-së të cilët janë shoqëruar në polici dhe të njëjtit, janë zëvendësuar nga të njëjtat subjekte dhe ka vazhduar procesi i numërimit të votave për kryetar komune dhe kuvendin komunal. Ndërsa, materialet sic është zarfi numër 1 dhe materialet tjera siç janë fletëvotimet, janë konfiskuar në polici. Nuk kemi detaje të hollësishme se sa është numri i fletëvotimeve dhe sa fletëvotime gjenden brenda zarfit numër 1, mirëpo këto janë informacionet që i kemi deri më tani ndërsa sa i përket kutisë së votimit dhe formularëve zgjedhorë, janë formularët për kryetar komune dhe kuvend komunal të rezultateve të kandidatëve; Janë në QNR dhe rekomandimi është se meqenëse i kemi materialet brenda të procedohen të rregullt por, sidoqoftë KQZ të vendosë...

Florian Dushi: Ne, jemi njoftuar në natën që ka ndodhur ky problem që më shumë do ta quaja improvizim i problemit, mirëpo megjithatë policia është marrë me rastin dhe unë e di që problemi qëndron me disa fletëvotime të paplotësuar. Materialet i kemi në rregull të gjitha dhe ashtu i procedojmë duke u bazuar në formularin e përputhjes së rezultateve, në listën e votuesve dhe të ngjashme, prandaj janë materiale të cilat janë plotësuar nga ekipi i ri apo këshilli i ri i vendvotimit sipas kërkesës që është bërë atë natë prandaj, unë konsideroj që nuk ka asgjë të keqe që kjo të procedohet ashtu siç, është rekomanduar edhe nga QNR si e rregullt sepse, asgjë kontestuese në formular nuk ka dhe formularët janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit.

Alim Rama: Duke marrë parasysh se e shpjegoi krye shefi se zarfi numër 1 përmban fletëvotimet e dëmtuara, fletëvotimet e dëmtuara janë dhe nëse vazhdojmë më tutje, ne, përsëri nuk jemi në gjendje me dëshmuar sa kanë qenë ato të dëmtuara apo të zbrazëta sepse, të gjitha fletëvotimet e një vendvotimi janë pjesë e procesit, çka nëse vazhdojmë më tutje dhe kemi mospërputhje të të dhënave...?

Burim Ahmetaj: Sa i përket çështjes administrative këto i plotësojnë kriteret, kushtet për me u procesu në rregull sepse është kutia e votimit, janë formularët e rezultateve qoftë për kryetar komune qoftë për asamble komunale, është lista përfundimtare e votuesve pastaj përmbajtja duhet me iu nënshtruar procedimit në futjen e të dhënave...Por, megjithatë, QNR-ja është e gatshme çfarëdo vendimi që merr KQZ-ja me autorizuar QNR-në...

Florian Dushi: Unë besoj se formularët përmbajnë të dhëna mbi atë se sa fletëvotime janë të zbrazëta ose janë gjetur të zbrazëta prandaj, këtu nuk ka të dhëna të cilat nuk mund të verifikohen dhe madje, të konfirmohen...

Arianit Elshani: Disa pyetje për krye shefin: E para, fletëvotimet e plotësuar ku janë dhe ku janë fletëvotimet e paplotësuar...? Edhe në raport edhe me formularët: Ku janë formularët e rinj dhe ku janë

formularët e vjetër...? Le të sqarohet si duhet se, nuk e kam të qartë kështu siç u fol deri më tani lidhur me këtë fletëvotim...

Burim Ahmetaj: Natyra e problemit të këtij vendvotimi, është raportuar nga KKZ-ja se mungojnë disa materiale, dhe ne, për faktin se kemi të gjitha materialet, pra e kemi kutinë e votimit, i kemi formularët e rezultateve qoftë për kryetar komune apo kuvendin komunal, e kemi listën përfundimtarë të votuesve dhe librin e votimit, proceduralisht ne kemi mundur me e proceduar në rregull dhe se nuk e kemi ditur dhe në asnjë rrethanë nuk e dimë gjatë pranimit të materialit se çka përmbajnë apo ku janë fletëvotimet...! Ne, supozojmë se gjithçka është brenda, pastaj prej fletëvotimeve janë përshkruar rezultatet në formular të rezultateve kështu që, kjo ka ardhur dhe është dërguar në karantinë si rezultat i sinjalizimit nga KKZ-ja se këtu ka pasur një problem dhe, kjo ka qenë arsyeja që ta raportojmë edhe para jush...

Ilir Gashi: Përderisa në bazë të procedurave të QNR-së gjithçka është në rregull dhe në qoftë se se nuk ka ndonjë ankesë nga palët e përfshira në proces, qoftë nga ndonjë subjekt politik apo si pjesë e hetimit të problematikës që ka mundur të ndodhë në atë vendvotim, atëherë për faktin se ju edhe po garantoni se në bazë të procedurave është gjithçka në rregull, pse të mos procedohet si e rregullt ? Ne, nuk e dimë se ka ndonjë ankesë në PZAP lidhur me këtë vendvotim nga kushdo qoftë dhe çfarëdo vendimi të mëtutjeshëm që mund të vie në qoftë se ka ankesë nga instancat tjera, atëherë ne do ta respektojmë qoftë edhe nga heqja nga rezultatet përfundimtare atë vendvotim apo, çka do që merret...

Tash për tash, nuk po shoh se diçka që nuk do të duhej me e proceduar si e rregullt...

Sami Kurteshi: Nga e gjithë kjo na e kemi një vendvotim .. unë vetëm dua që me e kuptuar kështu objektivisht....qysh është e mundur me qenë një kuti krejt në rregull kurse në polici janë disa zarfe me fletëvotime ,si ma shpjegoni objektivisht si është e mundur këto materiale ?

Unë e kam vërtetë pyetjen këto materiale i takojnë kësaj kutie por i ka marrë policia nuk janë në këtë kuti mirëpo kutia është në rregull ,objektivisht kisha dashur ta di si duket kjo .

Florian Dushi: Problemi është me një improvizim dhe që ka pasur për qëllim me e mbajtur peng rezultatit në komunën e Fushë Kosovës. Improvizim është dhe ka qenë improvizim sepse, kanë ardhur tre persona të tjerë të subjekteve të ndryshme politike dhe e kanë kryer krejt punën. Asgjë nuk ka pasur aty që është ndalur procesi. Prandaj unë e kam një pyetje për krye shefin: Sipas asaj që e dimë 80% të formularëve janë proceduar si të rregullt, sa materiale prej këtyre 80 % i keni kontrolluar në kuti...? Prandaj, ne e dimë problemin dhe e dimë që kemi improvizuar vetë atje, dhe po vijmë në këtë nivel. Nëse për 80 % të kutive të votimit nuk ka qenë problem ekzistimi apo jo i materialeve brenda kutisë por i kemi proceduar dhe

kemi krijuar rezultate vetëm për bazën e rezultateve përputhjes së rezultateve të cilët vlerësohen si në rregull nga ana juaj, tash provohet me u problematizuar rasti. Prandaj, është mirë atëherë që të krijojmë praktika të tilla dhe të mos e falim besimin tonë në përputhje me procedurat e QNR-së vetëm të formularëve të përputhjes së rezultateve, por të i hapim të gjitha kutitë dhe të shohim vërtetë nëse ato materiale ekzistojnë brenda. Është fjala për 20 fletëvotime të paplotësuara për të cilat është krijuar problemi...

Alim Rama: Unë po shoh se policia ka ndërhyrë! Kolegu Dushi e përmendi se kanë qenë 20 fletëvotime të zbrazëta, tash në këtë aspekt pa një verifikim ose pa një hetim të mëtutjeshëm, ne nuk mundemi me ditë a janë përdorur më shumë fletëvotime në mënyrë të parregullt...? Vetë fakti që ky vendotim ka pasur intervenim, ka pasur bllokadë dhe kjo është raportuar menjëherë pas mbylljes së vendotimeve. Tash ne mundemi me iu referuar dhomës operacionale se kur është raportuar, por në momentin që është raportuar ky rast ne nuk kemi ditur rezultatet në Fushë Kosovë kështu që, me vetë faktin se mungon një pjesë e materialeve dhe ne kemi raport policor që mungon një pjesë e materialeve, unë nuk po shoh kurrfarë logjike që kjo të procedohet si e rregullt! Unë mendoj që ne duhet me e vazhduar hetimin...

Sami Kurteshi: Unë, e dëgjova edhe z. Dushi me kujdes. Tash, unë po them sinqerisht për vete më së pari se as nuk po e di çfarë problemi ka pasur se, nuk jam marrë me dhomën operative...! Policia, ka shkuar i ka marrë ata njerëz, a po ? A, i ka marrë ne vendotim, a jo ? Natyrisht, unë po e shoh se kolegët krejt e dinë problemin dhe se çfarë është improvizuar! Unë veç një po e di: se material nëse ka në hetuesi, në dashtë ta zvarritet procedimin - në dashtë të mos e zvarrit, qysh do, ato janë në polici...! Pa e kthyer policia me një vendim se gjithçka është në rregull, kjo nuk mund të procedohet në rregull...

Burim Ahmetaj: Ne, i kemi këtu para vetes tri fakte e para sipas procedurave rezulton se materialet administrative formularët e rezultateve dhe gjitha materialet tjera përcjellëse nuk kanë probleme në këtë fazë të pranimit të materialit të ndjeshëm, e dyta e kemi policinë e Kosovës e cila ka zhvilluar hetime dhe i ka bërë thirrje KQZ-së që tre persona nuk mund të vazhdojnë punën ndërsa mund të vazhdoni punën duke i zëvendësuar ata, KQZ përkatësisht KKZ në komunën e Fushë Kosovës në bazë të autorizimeve nga KQZ ka bërë zëvendësimin e të njëjtëve me anëtarë të këshillave të vendotimeve nga të njëjtat subjekte, puna ka vazhduar dhe si rezultat i kësaj kemi edhe faktin e tretë që është kryer numërimi i fletëvotimeve të atij vendotimi, janë gjeneruar rezultatet, janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e këshillave të vendotimit edhe me përbërjen e re dhe tash neve do të na duhet ato materiale me i procesu si të rregullta sepse nuk ka administrativisht në këtë fazë nuk ka asgjë që e ndalon proceduralisht procedimin e tyre...

Alim Rama : Anëtarë të cilit subjekt kanë qenë këta komisionarë ? Këtu, e kemi një problem logjik: kjo mundet me u duk e rregullt por, në qoftë se i heqim krejt pjesët si mundet me qenë e rregullt ? Kutia është e rregullt, por unë nuk pash asnjë hetim; Neve na mungojnë materialet po na rekomandoni me vazhdue të rregullt dhe unë rekomandim më skandaloz nuk kam parë! Ne, i kemi pasur në zgjedhjet e shkurtit, më kujtohet diku në komunën Skenderaj ose të Drenasit ka qenë po ashtu, një problem ku ka intervenuar policia dhe ajo kuti nuk është procedua si e rregullt! Në momentin që ka intervenuar policia, janë marrë disa materiale për prova nuk është proceduar si e rregullt. Pavarësisht, unë nuk dua të paragjykoj mundet me qenë të gjitha votat e vlefshme...

Florian Dushi: A keni vendim të policisë apo të konfirmuar diçka prej policisë se, çka kanë marrë ata prej materialeve ?

Burim Ahmetaj: Nuk e kemi konfirmimin siç e kanë marrë se, ajo është pjesë e hetimeve. Ne, nuk kemi pas as autorizimin me e pyet se çka kanë marrë mirëpo, ajo çka ka lejuar është me u zhvilluar procesi i numërimit nga policia e Kosovës; Policia ka lejuar që të vazhdojë procesi i numërimit me kusht që të zëvendësohen ata tre persona me tre komisionarë tjerë...

Kreshnik Radoniqi: Burim këtu po shkruan zarfi numër 1 me disa fletëvotime është në polici. Pra, çka ka në zarf ?

Sami Kurteshi: Unë e kam një pyetje, ti dallojmë rolet: policia është për mbajtje të rendit dhe të sigurisë por nuk është për rregullsinë e procesit. Rregullsinë e procesit në aspektin teknik dhe administrativ, e garanton KQZ-ja dhe jo policia...

Arianti Elshani: Ajo çka e tha z. Dushi më herët, vërtet është ashtu që ne nuk e dimë realisht çka ka neper kuti të votimit për gjitha kutit e votimit, pra ne çka konstatojmë: konstatojmë prej formularëve të rezultateve që neve na vijnë...Me atë, konstatojmë që kutia brenda është në rregull në tersi, pra siç e ka lenë kryesuesi apo, siç e ka lenë i gjithë këshilli i vendvotimit. Edhe në këtë rast, ne po e dimë që kutia në tersi nuk është e plotë pra, sipas këtij raporti përshkrimin siç e kam është zarfi numër 1 me disa fletëvotime, është në polici.

Unë, pyeta qëllimshëm që më pas të qartë të gjithë: A behet fjalë për fletëvotime të zbrazte që janë në polici apo, për fletëvotime të plotësuar që janë në polici...?

Burim Ahametaj: Nuk e thash në asnjë mënyre se policia e Kosovës ka vendosur si më proceduar ne, mirëpo ajo çfarë e ka ndaluar është se ka ndaluar tre komisionar me marr pjese në numërim. Si rezultat i

kësaj, është bere zëvendësimi nga KKZ-ja në komunën e Fushë Kosovës dhe, kemi konfirmime së ne zarfin numër 1 kemi fletëvotimet prandaj, çka kane konfiskuar ? Kanë konfiskuar fletëvotime të pa vlefshme dhe fletëvotimet e dëmtuara. Këshilli i vendvotimit në baze të autorizimeve nga KKZ-ë në Fushe Kosovë ka vazhduar procesin e numërimit: ka numëruar të gjitha fletëvotimet e vlefshme, të pavlefshme, të dëmtuara, të zbrazëta. Të gjitha, sipas ligjit dhe proceduarave që i ka përcaktuara KQZ-ë. Kanë marr përgjegjësi, kanë nënshkruar të gjithë në formularin e rezultateve dhe të njëjtit formularë të rezultateve janë dërguar në QNR, dhe ne e marrim këtë fazë si të mirëqenë...

Alim Rama: Unë, e kam ditur që natën e mbrëmjes ka pas problem dhe ka intervenuar policia, unë tu e dite që diçka nuk është në rregull, d.m.th mungon ti nuk mundesh më e krye ciklin e përputhjeve sepse ty të mungojnë disa fletëvotime ndash të dëmtuara ndash të pavlefshme. Unë, pres ende me më treguar cilët kane qene ata tre komisionar dhe ato duhet më kane evidente unë pres po ashtu, për më vazhduar më tutje për më trajtuar këtë si pike pres raportin e KKZ-së që ka vendosur që janë mbledhur, që kane vendosur më proceduar këtë vendvotim mendoj zyrtari komunal nuk është i autorizuar më vendos në këtë faze, në qofte së KKZ-ja në tersi ka vendosur tani edhe më shumë po hapet këtu telashe më shumë sesa që kemi kështu që unë mendoj që kjo është një absurd edhe më i madh së pa pasur probleme nuk kish intervenuar policia sepse ne kemi pasur 2477 vendvotime vetëm një ka intervenuar policia...

Burim Ahmetaj: Në baze të procedurave që kemi para vetes, të cilat i ka miratuar KQZ-ë në këtë faze nuk ka diçka që e ndalon mos procedimin e tyre, që kemi procedurën përpara që na obligon më proceduar sipas procedurës më formular të rezultateve të cilët i kane sjell dhe në baze të ç 'kafit tash duhet të procedohen.

Kreshnik Radoniqi : A mundem vetëm diçka: A ka mundësi që këtë vendvotim 0906E10/01D me e hap, me e ba rinumërimin e krejt votimeve...?

Florian Dushi: Ne, nuk mundemi për hatër as për hire për kundër kritereve që janë të përcaktuara ose kushteve të cilave ne duhet më i rinumëruar vendvotime ose më anuluar pjesërisht vendvotime ose tërësisht vendvotime me gjet kompromise. Ne, nuk jemi këtu me gjet kurrfarë kompromisi, e kemi rekomandimin e QNR-së përpara...

Në vazhdim të këtij rekomandimi, diskutuan përsëri: Sami, Arianit Elshani, Alim Rama, Burim Ahmetaj, Florian Dushi dhe Ibrahim Selmanaj.

Kreshnik Radoniqi: Unë, e hedh në votim rekomandimin numër gjashte (6).

Kush është për ?

Rekomandimi i gjashtë, nuk u miratua.

Pastaj, kryetari z. Radoniqi, pyeti anëtarët e KQZ-së se kush nga anëtarët është për rinumërimin e këtij vendvotimi ?

Për të dhënë më shumë shpjegime, **Burim Ahmetaj** tha se tani jemi në një sitat tjetër ku neve na duhet patjetër më ba hetim brenda kutisë së votimit. Ato që janë konfirmuar deri më tani ato që janë të konfiskuar nga policia e Kosovës janë fletëvotime të cilat janë të dëmtuara gjatë ditës dhe fletëvotimet të pavlefshme që në asnjë rast nuk ndikojnë në rezultatin. Mirëpo, si rrjedhojë e kësaj, ne do të bëjmë hetimin bazë sipas procedurave që na lejojnë me u bërë një hetim: sa fletëvotime kane qene në atë vendvotim, sa votues kanë votuar, sa kemi fletëvotime të vlefshme dhe të pavlefshme, fletëvotime të dëmtuara gjatë ditës, dhe fletëvotime të cilat janë të pa përdorura... ?

Në baze të kësaj, do të ja përshkruajmë krejt gjendjen...

Ilir Gashi: Duhet me i dhanë një epilogë kësaj çështje ? Pak a shumë, tani u qartësua pak nga kjo çka tha Burimi sepse, në qoftë se ata kane materiale, fletëvotime të mbetura ose të dëmtuara gjate ditës kurse të gjitha fletëvotimet që gjinden në kuti përputhen më nënshkrimet por edhe më fletëvotimet e mbetura të thata atëherë, unë absolutisht jam pro që kjo të ec tutje sepse, edhe po të donim ne nuk mund të vepronim në asnjë variant tjetër: qoftë edhe me e anuluar për shembull një vendvotim sepse, s'ka asnjë bazë por mendoj që është mirë ta shtyjmë! Le ta marrim një raport policorë apo nga prokuroria, varësisht se ku ndodhet lënda...

Kreshnik Radoniqi: Unë mendoj që duhet me ardhur më shumë informacione pak më të sakta lidhur me atë krejt se çka ka marr policia dhe, sa ndikojnë ato në procesin e numërimit apo, a kanë ndikuar apo s'kanë ndikuar dhe, pastaj të vini me rekomandim të ri, me kaq përfundoi kjo pjesë...

Burim Ahmetaj: Në tabelë, janë edhe disa materiale të cilat nuk kane ardhur: në liste e keni edhe një tabele prej dy vendvotimeve që na duhet me verifikuar prej KKZ-ve për materialet të cilat nuk kane ardhur kështu që, jemi në komunikime më KKZ-të deri sa të na sjellin këto materiale që kane munguar gjate procesit të numërimit. E keni të listuar edhe çfarë materiali na mungojnë edhe do të duhet më u verifikuar prej KKZ-së po ashtu e kemi sjelle para juve edhe një raport që bazohet në rregullën nr 3 / 2 të rregullores 6/2013 ku thotë së brenda QNR-së jo më tepër së katër vëzhgues të akredituar nga e njëjta organizate të akredituar mund të jene të pranishëm njëkohësisht për të vëzhguar zgjedhjet ndërsa neni 3.3 i jep

mundësi KQZ-së që të rris numrin e vëzhgimit. Më qene se tani planifikimi që janë bere në QNR-ë dhe janë 20 njësi të numërimit dhe më katër vëzhgues të akredituar nga e njëjta organizate nuk mundet të mbulohet vëzhgimi i procesit ne të njëjtën kohe rekomandojmë që ky numër të rritet varësisht sa është numri i tavolinave të numërimit kjo nënkupton së janë 20 tavolina në QNR-ë dhe rekomandimi është që të lejohen 20 vëzhgues nga e njëjta organizate e akredituar dhe në rast se ka aktivitete tjera që zhvillohen të njëjtën kohe në qendrën e numërimit dhe rezultateve të jene edhe dy vëzhgues shtese kjo n 'varët gjithmonë nga situata por rekomandimi është që të shtohen edhe 20 vëzhgues në njëjtën kohe nga 4 në 20 në njëjtën kohe dhe dy vëzhgues shtese në mënyre që të përcillni aktivitetet tjera.

Sami Kurteshi: Faleminderit shumë, edhe për raportimin unë i kame dy pyetje: A do të mbeten vetëm 20 tavolina në numërim, s' do të ketë më shumë, në rregull...! E dyta, çfarë procese tjera ka që ka nevojë edhe për dy vëzhgues shtesë që me e ditë, a ka edhe më shumë procese...

Arianit Elshani: Po e kuptoj që janë 20 vëzhgues për njësinë e numërimit por e kemi edhe njësinë e data entry edhe të skanimit besoj që edhe këta sektorë kane nevojë për vëzhgime janë të interesuar palët qofte organizatat qofte subjektet politike për të vëzhguar këtë mirëpo edhe si rekomandim që më erdhi vetëm për njoftime në raport më drejtorin e QNR-së që njoftimi tash më ka shkuar të subjektet politike në raport më këtë rekomandim që e kemi, sidoqoftë unë jam për, kam qene për edhe në zgjedhjet e fundit që të shtohet ky numër për shkak të interesit të gjithë vëzhgueseve edhe të atyre kandidateve për asamble komunale të kaluarën edhe për deputet që të vëzhgojnë nga afër këtë proces të numërimit të rezultateve.

Sidoqoftë, ne kemi marr masa që i gjithë ky proces të monitorohet gjate ter kohës edhe nga kamerat edhe mendoj se vërtet sa i përket QNR-së kemi bere një punë jashtëzakonisht të madhe gjatë kësaj kohe duke e rritur edhe duke kërkuar përgjegjësi dhe llogari nga secili punonjës që është atu brenda, andaj nëse ka mundësi që ky numër të shtohet në rregull në qofte se ju mendoni që për shkak të rrethanave të pandemisë edhe hapësirës së QNR-së që është e mjaftueshme për gjitha subjektet re rregull. Faleminderit

Alim Rama: Unë jam në rregull me pas ky numër por, me e lehtësuar komunikimin e vëzhguesve brenda për brenda, unë kisha kërkuar nga sekretariati që së paku dy vëzhgues me pasur edhe telefona për shkak të lehtësisë së komunikimit; dy vëzhgues që janë në dy grupe jo të gjithë; unë e kuptoj që atje duhet me kane të qete edhe mos më u penguar por vështirësohet komunikimi i vëzhgueseve pastaj, kur vjen puna e ndërrimeve dhe këto senet tjera kështu që dy vëzhgues më pas telefonat.

Burim Ahmetaj: Kemi vlerësuar se 20 njësitë e numërimit, nuk e cenojnë integritetin e zgjedhjeve dhe është lehtë të monitorohem të vëzhgohet edhe prej KQZ-së, dhe lehtë për mu vëzhguar edhe nga

subjektet politike. Sa i përket numrit të vëzhgues shtesë, kemi besuar së raportimet e më hershme të gjitha formularët e rezultateve i kemi masën 80% të proceduar kështu që kemi aktivitete shumë më pak në ato hapësira që konsiderojmë që më këta dy vëzhgues shtese do mund të mbulohet edhe ajo pjese ku nuk do të punohet intensivisht por punohet varësisht prej materialeve që kështu nëse konsideroni që numri të jetë më i madhe nuk është ndonjë probleme për QNR-ë mirëpo kjo ka ardhur si rezultat i progresit apo procedimit të materialit zgjedhore që kemi diku më shumë së 80% të proceduar ndërsa sa i përket rolit të një vëzhguesit apo koordinatorit që koordinon të gjitha aktivitetet as të kaluarën nuk ja kemi ndaluar një personit që të ketë telefonin më kushtin që të mos përdoret për qëllime të fotografimit apo incizimit tjera por vetëm për qëllime të komunikimit dhe koordinimit brenda subjektit të vet. Ndërsa pajisjet tjera laptop janë lejuar gjithmonë vazhdimisht për gjithë vëzhguesit që të kenë mundësi të punojnë edhe më pashijet e tyre në QNR-ë...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka, kush është për aprovimin e këtij rekomandimi për rritjen e numrit të vëzhgueseve në QNR-ë.

Burim Ahmetaj: Më lejoni të ju njoftojë që tani procesi i rinumërimit, do të fillojë në ora 17:00 dhe, gjitha përgatitjet i kemi bërë qofte me njoftimin e vëzhguesve dhe gjitha palëve tjera që, do të fillojë procesi i rinumërimit në ora 17:00 në QNR-ë.

Sami Kurteshi: Një pyetje të fundit: Sa i përket rinumërimit në QNR-së, sa po bëhet numri total i të gjitha kutive pa marr parasysh arsyet që do të rinumërohen, përveç atyre që kemi vendosur në mënyrë të rëndësishme me zgjedhë... Sa do të jete numri total i rinumërimit ?

Burim Ahmetaj: Për rinumërim, ndoshta është pak herët më fol së jemi në këtë faze të pranimit që për shkak të parregullsive administrative nuk kane mundur mu proceduar si të rregullta se thash edhe më herët që s'përputhen numrat e shiritave; FPR-të kane qene të pa plotësuara dhe të pa nënshkruara prej KVV-ë apo, të plotësuara pjesërisht. Pra, këto janë arsyet që gjitha këto vendvotime, 23, shkojnë në rinumërim dhe nuk mund procedohen si të rregullta. Ndërsa sa i përket auditimit, jemi duke punuar në procesin e auditimit të gjitha atyre rasteve mirëpo, nga raportet që kemi, nuk kemi masë të madhe qysh kemi krahasuar me zgjedhjet e 4 shkurtit ku, kemi ma pak se 100 vendvotime të cilat aktualisht, i kemi sipas raportimeve në auditim...

Ndërsa, sa i përket hetimit, tani do të fillojë procesi i verifikimit të të gjithë formularëve sipas metodës së rastësishme, duke i krahasuar të dhënat e shënuara të formularet e kandidateve me të dhënat e shënuara

në fletat llogaritëse të kandidateve dhe besojmë se brenda dy ditësh, do të kemi raportin për të prezantuar në KOZ-ë: raport në verifikimin e të dhënave në FRK-ë, dhe fletat llogaritëse.

Arianit Elshani: Atëherë, po kuptoj që ky numër prej 23 kutive që do të hynë në rinumërim janë kuti që janë konstatuar nga pranimi i materialit - vetëm nga pranimi i materialit dhe tani, në momentin që hynë në auditime – në momentin që kemi mos përputhje të të dhënave në sistem, do të hyjnë edhe të tjerat në rinumërim në qofte se do të ketë të tilla...Ne, kemi vendosur një normë prej 10% te kutive të votimit për komunë që të hyjnë në verifikime të flikave me formular të rezultatin e kandidateve dhe, në qoftë se ka lëshime të tilla dhe dallime mes flikave dhe rezultateve formularëve të kandidateve, atëherë do të kemi pastaj rinumërim të atyre kutive. Pasi që të bëhet ky verifikime, do të kemi një rinumërim të disa kutive në qofte se konstatohet se ka mos përputhje mes flikave dhe formularëve të rezultateve se, ky ka qene vullneti ynë kur kemi votuar KOZ-ë.

Kreshnik Radoniqi: Po vazhdojmë...E kemi këshillin për Buxhet dhe Financa...

2. Raport i Këshillave të KOZ-së

1. Këshilli për Buxhet dhe financa

Shqyrtimi dhe miratimi i shumës së pagesave për stafin e angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për zgjedhjet e lokale 2021:

Gordana Llaban: Në mbledhjen e 19-të të këshillit për Buxhet dhe Financa, ne kemi marrë një vendim edhe e kemi para vetës për pagesën e personave të angazhuar në Qendrat e Votimit dhe në Vendvotime për këto zgjedhjet e lokale. Rekomandimin e kemi para vetës...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit, lidhur më këtë, urdhëro Alim... ?

Alim Rama: Vetëm një pyetje: Ne kemi pas ndërkohë edhe një mbledhje se paku pse ky rekomandim nuk është trajtuar para zgjedhjeve, mos e kemi trajtuar edhe një herë, pse s'ka ardhur në KOZ-ë mbledhjen e të shtunës... ?

Arianit Elshani: Lidhur më këtë rekomandim jam që të miratohet mirëpo, kam një kërkesë nga sekretariati dhe veçmas zyra e terrenit dhe këshillat e vendvotimit që, të kemi një confirmim: e di që keni kërkuar një letër confirmime bankare nga secili anëtar i këshillit të vendvotimit mirëpo, të finalizohet edhe të

plotësohet deri tek personi i fundit që është angazhuar gjatë ditës së zgjedhjeve për shkak se ndoshta edhe ky rasti i z. Kurteshi, besoj ka edhe shumë raste të tjera për të cilat nuk kryhet pagesa për shkak që ata kanë dhanë llogari bankare të prindit, të vëllait, motrës apo të ndonjë të afërmi të tyre dhe, e di që shumë shpesh kam pasur raste të tilla kur më kanë kontaktuar dhe gjitha ato janë drejtuar tek sekretariati për tu shqyrtuar nga sekretariati në qofte se kanë qene të angazhuar në ditën e zgjedhjeve dhe që të konfirmojnë llogarinë bankare në bankën e tyre, dhe pastaj edhe në KQZ-ë prandaj, kërkoje që mos të kemi ndonjë prolongim siç, është rasti i këtij personit në vitin 2017.

Pra, të i rrimë gati të gjithë këta që kanë qene të angazhuar në këto zgjedhje të paguhen më kohë...

Kreshnik Radoniqi : Faleminderit, atëherë nëse nuk ka diçka tjetër e hedh në votim, kush është për ?

Më 10 vota për miratohet vendimi për miratimin e shumës së pagesave për stafin e angazhuar në qendra të votimit në vendvotime.

2.Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional të zgjedhjeve lokale 2021, raundi i dytë për kryetar të komunave:

Arianit Elshani: Faleminderit kryesues, KOZ e ka shqyrtuar vendimin e sekretariatit për planin operacional të zgjedhjeve lokale 2021 për rundin e dytë për kryetare të komunave. Kemi shqyrtuar çdo aktivitet që parashihet brenda planit operacional duke ju përshtatur datës së mbajtës së zgjedhjeve, periudhën e fushatës së subjekteve politike pra që të jete pese dite pra pastaj edhe afatet tjera që kemi ndryshuar që janë më përbërjen e këshillave të vendvotimit që të njoftohen subjektet politike për të i konfirmuar dhe për të i përditësuar listat e tyre dhe të njëjtat, edhe për vëzhguesit që do të jene të angazhuar në ditën e zgjedhjeve. Ne, gjatë ditës së nesërme, do të mbajmë edhe një mbledhje të KOZ-it për një pikë e cila është shqyrtuar sot gjatë këshillit mirëpo, duke mos qenë të gjithë anëtarët prezent në këtë këshill kemi lanë që të shqyrtojmë nesër, rekomandojmë si këshill së ky plane operacional të miratohet faleminderit.

Burim Ahmetaj : Faleminderit kryetare, e kam propozuar më herët që mu fut si pikë e rendit të ditës caktimi i ditës apo rundi i dytë për zgjedhje kështu që, është dashtë mu parapri para së mu votuar plani operacional. Nëse është e mundshme të shqyrtoni ose ta vendosni ditën e zgjedhjeve për rundin e dytë pastaj të kalohet në planin operacional.

Kreshnik Radoniqi: Në rregull, po e votojmë vendimin për rundin e dytë, sipas vendimit zgjedhjet për rundin e dyte do të mbahen më 14 Nëntor. Kush është për ?

Atëherë, miratohet vendimi për rundin e dytë.

Sami Kurteshi: Lidhur më rundin e dytë, unë kame pyetje lidhur me listën votuese: A rifreskohet, lista votuese duhet të rifreskohet. Unë kam mesazhe nga njerëzit që janë jashtë si është puna e atyre që nuk janë regjistruar në rundin e pare për votim por më gjase janë të interesuar në rundin e dyte, unë kom bere përpjeke më pa rregullën ligjin por nuk kam dashtë më dhanë një përgjigje për arsye kame dashtë që kjo çështje si është e rregulluar, realisht rifreskimi i listës votuese i merr parasysht gjithë ata njerëz që kane drejt vote ose që regjistrohen për drejt vote, ka prej tyre që nuk janë regjistruar herën e pare duan të regjistrohen herën e dyte vetëm si qytetare tregojnë që nuk votojnë në Kosove po votojnë nga jashtë. Si është e rregulluar ose si do të rregullohet edhe nëse po kur do të fillon faza e regjistrimit edhe faza e dërgimit të votës, Faleminderit.

Arianit Elshani: Vetëm më shtuar se ne e kemi diskutuar këtë në këshill të operacioneve zgjedhore dhe KOZ-ë ka marr një njoftim nga drejtori i zyrës ligjore së kjo çështje është trajtuar edhe më herët KOZ-i dhe nga përbërjet e kaluara të KQZ-së që lista votuese të përditësohet në rundin e dyte ne vërtet kemi vepruar kështu më Podujevën por rasti i Podujevës ka qene ndryshe se nuk është mbajtur fare dita e zgjedhjeve edhe për këtë shkak është përditësuar lista votuese njoftimin që kemi marr nga zyra ligjore po ashtu është që një rast i tille ka ndodhur kur disa persona janë ankuar disa qytetare te komunës së Istogut janë ankuar në gjykatën supreme dhe më tej kane ngritur çështjen edhe në gjykate kushtetuese më që rast ka dal një gjykime që atyre personave nuk ju është lejuar votimi për shkak së rundi i dyte konsiderohet si vazhdimësi e rundit të pare dhe më që qytetareve ju hiqet e drejta për të kandiduar në rundin e dyte të njëjtëve nuk ju lejohet edhe votimi në rundin e dyte.

Ky, është njoftimi që kemi marr dhe komfore këtij njoftimi në kemi aprovuar në këtë plane operacional dhe në momentin që njoftohemi që një akt gjykim i tille nuk qëndron apo nuk ka diçka te tille sigurisht që ne kemi më dhanë mbështetjen që kjo të behet në qofte së mundëson ligji për zgjedhje dhe kushtetua e republikës së Kosovës, sa i përket opsionit të votimit përmes postes edhe këtu duke e pasur këtë parim në raport më listën votuese brenda vendit i njëjti parim është edhe për rastin e votimit përmes postes ky është standardi që është vendosur tani drejtori ndoshta mund të na jep një përgjigje më këtë çështje të cilën e kemi trajtuar në këshill.

Sami Kurteshi: Tani me sa kuptova, ka mbet zyra ligjore më na sjell këtë vendim të gjykatës supreme apo kushtetuese cila është që për rundin e dyte nuk kane drejte mu regjistruar ata që s'janë regjistruar.

Xhemajl Peqani: Përshëndetje kryetar, përshëndetje të gjithëve, po kjo çështje është trajtuar në KOZ-ë dhe pas kësaj jam obliguar që të jep një sqarim lidhur më këtë çështje dhe ju njoftoj si në vijim:

Data e zgjedhjeve, është data e shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës, 17 tetor 2021, rundi i dyte i zgjedhjeve organizohet vetëm për kryetare të komunave si vijimësi e rudit të pare nëse asnjë prej kandidatëve nuk i ka mjaftuar votat e mjaftueshme kjo nënkupton se vetëm rundi i par është rund i rregullt për të cilin vlen edhe afatet përkatëse ligjore, neni 45 kushtetutës së Republikës së Kosovës thekson cdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeçare qofte edhe në ditën e zgjedhjeve gëzon të drejtën të zgjedh dhe të zgjidhet më përjashtim kur kjo e drejte kufizohet vetëm më vendim gjyqësor.

Rasti i Podujevës që e përmendi edhe z. Elshani, për kryetare të komunës së Podujevës ka qene tërësisht ndryshe më qen se ato zgjedhje ishin shty më vendim të Presidentit, në atë raste KQZ-ë ka qene e obliguar të përditësoj listën përfundimtare të votuesve sepse, vendimi për shpalljen e datës së re të zgjedhjeve është konsideruar si përfundimtar prandaj nuk ka mundur të ju mohohet e drejta qytetare, sepse ne e dimë që kjo zgjatje ka zgjatur më shumë së 6 muaj por edhe për ata persona që janë hequr nga lista.

Rregulla zgjedhore numër 10-ë / 12, 13 për rundin e dyte të zgjedhjeve k=për kryetar të komunës specifikon qartazi së në rundin e dyte të zgjedhjeve përdoret lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar në rundin e par po ashtu lidhur më pyetjen e z. Kurteshi kjo rregull në nenin 8 dhe 9 e kufizon të drejtën e votimit vetëm për qytetaret e jashtë vendit dhe at më nevoja te veçanta te cilët janë regjistruar në rundin e par, veprimi ndryshe ose përditësimi i listës votuese që do të nënkuptonte diskriminim e këtyre qytetareve më qene së do te zbatohej vetëm për votuesit brenda vendit dhe jo për votuesit jashtë apo për votuesit më nevoja te veçanta, edhe sa i përket votueseve të ri gjate kësaj periudhë që është prej rudit pare deri në rundin e dyte te votuesve të ri përditësimi i listës votuese do të nënkuptonte që do të cenonte parimin e se drejtës për të zgjedhe dhe për tu zgjedhur më qene se votuesi e ri do të kishin të drejtën për të zgjedh por jo edhe për tu zgjedhur.

Dhënia e mundësive që të shtohen apo të hiqen emrat nga lista votuese bijën ndesh edhe më parime ndërkombëtare të zgjedhjeve se vota duhet e barabartw dhe jo parciale. Vetëm më një rund të dyte të zgjedhjeve d.m.th, ky është interpretimi i zyrës ligjore ndërsa ata që përmendi Arianiti ka qen një rast i tille, ku ju të gjithë jeni dëshmitar në zgjedhjet për kryetare komune në Istog ka qene 3 runde rudi dyte

dhe është përsërit një here mirëpo nuk kemi mundur më gjete d.m.th jo gjykate kushtetuese mirëpo, një ankese më sa duket ka qene në PZAP-ë. Ky është interpretimi i zyrës ligjore.

Sami Kurteshi: Ky është interpretimi i zyrës ligjore që lexuat, cili është ai vendim i gjykatës supreme apo kushtetuese lidhur më pjesëmarrjen në zgjedhje, vetëm numrat ? KI01/18 kjo gjykata kushtetuese ky është vendimi, a...?

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, e hedh në votim planin operacional për rundin e dyte. Për kryetare komune, pra kush është për ?

Me vota unanime, miratohet.

Florian Dushi: Faleminderit nuk po dua ndoshta për mos më tingëlluar subjektivë për mos më interpretuar at vendim është mire më pa sepse vërtet është krejt ajo së çfarë po thotë z. Kurteshi në kuptimin qysh e trajton rundin e pare dhe të dyte si një proces unik dhe përfshirja e votueseve të ri që s'janë kane në rund të par mandej edhe më shembuj ekzemplar të shteteve dhe rasteve të tjera qysh zakonisht e bo gjykata kushtetuese por megjithatë unë po dua me tërheq vëmendjen e juaj edhe të diçka tjetër që ne e kemi një rregull zgjedhore përveç tjerave nr. 10/2013 e cila gjithashtu jep përgjigje në gjitha çështjet që u ngritën gjate këtij debati dhe po konsiderojë që është në harmo edhe më at vendimin i cili po referoheni.

Sami Kurteshi: E keni fjalën për nenin 8. Rregulla zgjedhore 10/2013 neni 8

Florian Dushi: Neni 6, lista votuese që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale do të përdoret për rundin e dyte të zgjedhjeve për kryetare të komunave.

Sami Kurteshi : Lista e njëjta po kjo liste duhet te rifreskohet, duhet mu rifreskuar sepse ka më pasur edhe arsye tjetra, d.m.th, lista qe marrim ne pra atu duhet më pas rifreskim prej personave që kane hekë dore nga shtetësia. Ne, s'mundemi më konsideruar lista si diçka që është e pa ndryshuar kjo nuk është doge ne jemi të interesuar më pas proces zgjedhore ku nuk marrin pjese në zgjedhje persona që nuk kane drejt më marr pjese ose në liste gjinden persona te vdekur prandaj kjo duhet te rifreskohet.

Ne, mund të kemi vendime të tilla dogmatike edhe vendimi i tille dogmatike duhet më u sqaruar në liste ne nuk mundem të lejmë persona që kane hequr dore nga shtetësia e kane marr vendimin edhe personave që kane vdekur prandaj duhet të rifreskohet lista një nëse rifreskohet në këtë drejtim nuk është e njëjta ajo njëjta nuk duhet më kane ajo liste ka më pas ndryshime.

E dyta, unë nuk po dua më thane asnjë fjale pa lexua këtë akt vendim të gjykatës kushtetuese, vetëm edhe gjykata kushtetuese sikur gjykata tjera e bëjnë dallimin se drejtës për më zgjedh edhe për mu zgjedhur nuk janë gjithmonë njëjta gjera, pa lexuar njëherë komplet akt gjykimin edhe më pa cilat janë arsyet unë mendoj që ne nuk kemi drejt më ja ndaluar një qytetari që s'ka marr pjese në zgjedhjet e para më marr pjese në zgjedhjet e dyta ai/ajo është qytetare i Kosovës dhe qytetare që jeton në Kosovë e ka at drejte s'dua më marr pjese në zgjedhjet e para tani po më rrezikohet interesi po dua më marr në zgjedhjet e dyta prandaj unë po dua më pa saktësisht edhe në këtë drejtime planin operacional nuk po dua më votuar sa i përket kësaj çështje unë abstenoj deri sa të sqarohet kjo...

3. Këshilli për marrëdhënie me Jashtë

Kreshnik Radoniqi: Vazhdojmë më këshillin për marrëdhënie më jashtë, për piken e vëzhgimit të procesit të printimit fletëvotimeve për rundin e dyte. Ne, e mbajtëm sot një këshill për marrëdhënie më jashtë këshilli nuk ke i plotë por patëm kurum, dhe sipas këshillit ne kemi ardhur me një propozim por, që ai propozim mund të plotësohet këtu.

Në komision, propozimi është që mbikëqyrjen e procesit ose vëzhgimin e procesit të printim për rundin e dytë të vëzhgohet nga një delegacion i përberë nga anëtar e komisionit: Ilir Gashi, Fazli Stollaj dhe Ibrahim Selmanaj, ndërsa nga krye shefi do të caktohet kush nga sekretariatit. A keni ndonjë propozime tjetër lidhur më këtë?

Sami Kurteshi: Ne, e kemi përcjell procesin në rundin e parë. Këta anëtar, nga biseda më ta nuk kam vërejte që ka ndonjë obligime aq të madh, sinqerisht po thamë me shkua dy vetë kish me qenë e mjaftueshme pse, unë kisha thanë me shkua vetëm dikush nga Sekretariati dhe, ai që është marr me dizajnonim e tyre...

Kreshnik Radoniqi: Mirë, nëse s'ka dikush tjetër, e hedhim në votim. Kush është për këtë propozim? Me vota unanime miratohet propozimi për vëzhgimin.

Alim Rama: Me qenë se ka filluar rinumërimi sot, unë e kisha rekomanduar Sekretariatit mos me pritë auditimin e të gjitha kutive por, me na sjellë në mënyre parciale sepse, ne kemi mbet 500 kuti me rinumëruar për çdo ditë, ose çdo dy apo tre ditë sa do që ka, varësisht prej progresit...

Burim Ahmetaj: Sonte, do të behet transporti i votave me post dhe do të transferohen në QNR-ë.

Arianit Elshani: Unë, e kam një pyetje lidhur më këtë çështje. Ndoshta na keni njoftuar por më ka ikur kjo informatë që procesi i verifikimit, a ka përfundua apo...? Nuk kam qenë në dijeni deri dje kur kam shkuar në QNR-ë dhe kam kuptuar që ky proces ka përfunduar aty, ndoshta ka pasur nevojë për vëzhgues aty...

Burim Ahmetaj: Nëse më lejoni me ju njoftuar, procesi ka filluar në ditën e diele dhe janë njoftuar vëzhguesit por, interesimi i vëzhgueseve me e përcjell procesin e vlerësimit ka qene pothuajse minimal ose zero. Ne, ju kemi bere ftesë çdo ditë, pra në baza ditore por nuk ka pas interesim....